

VENDIM
Nr. 92/2025

PËR MOSMIRATIMIN E KËRKESËS PËR ZHVILLIMIN E INTERPELANCËS
URGJENTE ME ZËVENDËSKRYEMINISTREN DHE MINISTREN
E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Në mbështetje të neneve 78, 80, pika 1, të Kushtetutës, neneve 89, pika 3, dhe 97, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin të një grupi deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e kërkesës për zhvillimin e interpelancës urgjente me Zëvendëskryeminstren dhe ministren për Infrastrukturën dhe Energjinë Belinda Balluku.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 6.11.2025.